

## CV E SHKURTUAR

### Prof Dr LORENC EKONOMI

Kam mbaruar shkollën e mesme të përgjithshme “Themistokli Gërmenji” Korçë në vitin 1982 me Medalje të Artë dhe po në këtë vit jam shpallur fitues në Olimpriadën Kombëtare të Matematikës. Nga viti 1982-1987 kam kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës në degën Matematikë Speciale 5-vjeçar me rezultate të larta duke u titulluar “matematikan”. Nga viti 1987-1992 kam punuar si matematikan në Institutin e Studimeve dhe Projektive Metalurgjike Elbasan dhe pedagog në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan. Me hapjen e Universitetit të Korçës, në vitin 1992, u ktheva në qytetin tim të lindjes për të dhënë kontribut në këtë universitet, të cilin e jap deri në ditët e sotme.

Gjatë kësaj periudhe kam qenë pjesë e Departamentit të Matematikës dhe për një periudhë 10-vjeçare përgjegjës i këtij departamenti. Në mandatin e fundit kam qenë zëvendës dekan i Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Humane. Jam nga themeluesit e degës së Matematikës dhe kam dhënë kontribut të rëndësishëm në ngritjen dhe vazhdimësinë e sukseshme të saj. Për tre mandate kam qenë senator i Universitetit të Korçës.

Në lidhje me kualifikimin shkencor mund të rendis:

- Studime Pasuniversitare në kuadër të SHPU për Statistikë Matematike, 1998-2000;
- Fitimi i gradës shkencore “Doktor i Shkencave” në Matematikë, në Universitetin e Tiranës, me vlerësimin “Shumë mirë” duke mbrojtur disertacionin me temë “Kontribut për vlerësimet jackknife dhe bootstrap në vlerësimet lineare”, datë 07.02.2003;
- Fitimi i titullit “Profesor i Asociuar” në Janar 2011;
- Fitimi i titullit “Profesor” në Shtator 2015.

Jam autor i 23 artikujve shkencore, shumica të botuar në revista shkencore ndërkombëtare të indeksuara, 3 monografive, 9 libra e dispenca. Kam marrë pjesë në 25 konferenca shkencore ndërkombëtare e kombëtare.

Kam kryer specializime jashtë shtetit ku veçoj: në Universitetin e Barit gjatë vitit 2001 në kuadrin e programit INTEREG II dhe në Universitetin e Bolonjës Itali gjatë vitit 1996 në kuadrin e projektit TEMPUS.

Kam qenë udhëheqës shkencor dhe oponent në disa studime doktorale të kryera nga anëtarë të departamentit tonë.

Jam koordinator për Universitetin e Korçës në projektin ERASMUS+ me titull “Strengthening Teaching Competences in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences” (TECOMP) 2019-2021.